




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPK	Nr. Prot. Bi Prot. Prot No. 03-02/4304/17
Nr. l. fol. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 29.12.2017
P. SHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3742/17, për z. Xhelal Musa, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Bifurkacioni Sh.A - Ferizaj, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Xhelal Musa Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Bifurkacioni Sh.A - Ferizaj, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në biznesin privat N.P "Lali", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë ka ndërmarr veprime procedurale për tu larguar nga funksioni person i autorizuar në biznesin privat.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/4194/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

